

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E MAMUSHËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugës Kultur, Pasha dhe Demirci në Mamushë.**

Nr i Prokurimit	626-25-8181-5-2-1
Nr i brendshëm	626-25-010-5-2-1

Sa i përket tenderit për: **Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugës Kultur, Pasha dhe Demirci në Mamushë.**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

“KAG – Asphalt Company” SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Krushe e Vogël
(Adresa)

Komuna e Prizrenit 20000
(Vendi)(Kodi postar)

+383 29210610
(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Bashkim Maliqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Kag_ks@yahoo.com
(Adresa elektronike)

07.10.2025
(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me **PROKURË**.*

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. Data e njoftimit për kontratë - 25.09.2025
2. Data e planifikimit të hapjes së ofertave - 13.10.2025
3. Kërkesa për Rishqyrtim –07.10.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☒

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1 - LPP-Qëllimi
- Neni 6- Ekonimiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7 - LPP - Barazia ne Trajtim/ Jo- Diskriminimi.
- Neni 28 - LPP - Specifikimet teknike
- Neni 69 - LPP - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Kronologjia e fakteve dhe Analiza e Kërkesës për Rishqyrtim

Kërkesë për Rishqyrtim të Vendimit të Autoritetit Kontraktues

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), konkretisht neni 108A, parashtrojmë kërkesën për rishqyrtim ndaj njoftimit përkontratë të autoritetit kontraktues, Komuna e Mamushëstë datës 25.09.2025, konkretisht ndaj kërkesave dhe specifikave të tenderit dhe kriterëve të vlerësimit në tenderin e shpallur me emër: **Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugës Kultur, Pasha dhe Demirci në Mamushë.**

Kërkesapër rishqyrtim do të fokusohet në kriteret e atakuara nga ana e jonë si më poshtë:

(Pika 1)

Kriteri që konsiderojmë si diskriminues është:

Kërkesat mbimundësitë teknikedhe/ose profesionale

1. Është kërkuar: 2.4. Një (1) inxhinier të diplomuar ose master drejtimi Hidroteknik, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune - angazhime profesionale pas diplomimit dhe të ketë menaxhuar së paku një projekt dhe të ofroj dëshmi për një menaxhim të tillë.

I certifikuar për testimin e produkteve. – kjo kërkesë është e parsyeshme dhe nuk është në përputhje me standartet dhe kërkesat në Kosovë e as në dosje të tenderit, pasi që puna që kërkohej të kryhej nga ky ing. nuk përkon me një kërkesë të tillë, dhe krijon shpenzime të panevojshme për kompaninë.

2. Një (1) inxhinier të diplomuar ose bachelor i Ndërtimtarisë drejtimi Inxhinieri e Ambientit, kërkohej të ketë min. 5 vite përvojë pune - angazhime profesionale pas diplomimit si dhe të jetë Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis. - Po ashtu kjo kërkesë është shumë e paarsyeshme pasi që punishtja ku do të kryhen punimet nuk paraqet rrezik të dëmtimit të ambientit, e aq më shumë kur kërkohej që ing. të jetë Ekspert i vlersimit të ndikimit në mjedis.

3. Është kërkuar edhe:

a) Një (1) teknik i ndërtimtarisë i certifikuar për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme inerte. – kërkesa e panevojshme pasi që aty nuk parashihet asnjë mbetje e rrezikshme.

b) Së paku dhjetë (10) punëtorë të rregullt ose me parakontratë të cilët duhet të jenë të certifikuar për mbrojtje nga Zjarri. - kjo kërkesë si shumë të tjera mbetet e panevojshme dhe punimet zhvillohen në rrugë në një ambient të jashtëm dhe kërkesa e tillë është e paarsyeshme.

Pika 2 – Kriter diskriminues janë edhe makineritë të cilat kanë pesha dhe emertime specifike andaj kërkojmë që të ndryshohen si p.sh.:

- Eskavator skip me regjistrim valid, Bullduzher me thikë lëvizëse në të dy krahët min. 40 tonë, Frezë montuese në eskavator për gërryerjen e asfaltit, gurit dhe betonit max. 500kg, Makinë për vendosjen e kubëzave të betonit min 1.5 tonë, pajisje (vakum) ngritëse për anësore të betonit max. 550 kg, kamion kiper me kran, pesha maksimale e ngarkesës së lejuar (pesha bartëse) 2 tonë, Kamion kiper me kran me peshe bartëse min. 7 tonë me atest, Hillt me derivate, Ngarkues me pirun dhe kove me kapacitet min. 2 tone me atest, burgji që montohet në eskavator për shpime horizontale dhe vertikale etj..

Kriteret e kërkuara si më lartë, si kufizimi i peshave të pajisjeve, specifikimi i modeleve të veçanta të pajisjeve si dhe kërkesa për lënë mundësi për alternativa, pa dyshim paraqesin kufizime të padrejta për konkurrencën dhe janë në kundërshtim me parimet e ligjit të prokurimit publik. Këto lloje kriteresh mund të favorizojnë disa operatorë ekonomikë, duke krijuar një barrierë të padrejtë për ata që nuk kanë në dispozicion pajisjet e kërkuara ose nuk mund të përmbushin kërkesat e tepruara të numrit dhe specifikimeve.

Dispozitat e shkelura nga ana e autoritetit kontraktues

Neni 1 – Qëllimi

Në rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm që nga ana e autoritetit kontraktues

nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2,4 i cili thotë se:

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1 i cili thotë se:

1.Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2,4 i cili thotë se:

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2.Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

1. Autoriteti kontraktuesdoti parashtrorjëtëgjitha specifikimet edetyrueshmeteknike nëdosjen e tenderit.Nëseaktivitetipërkatësiprokurimit kërkonpublikiminenjoftimittë kontratës,autoriteti kontraktues(i)do tëparashtrorjësifikimetetillanënjoftiminnë fjalë,ose(ii)dotë dërgojnëjë deklaratëtëqartëqëregonsekumundtë merrenspecifikimetetillateknike.Kurdoqëështë mundurkëtospecifikimeteknikeduhettëdefinohennëatë mënyre saqëtëmerrenparasysh kriteretpërmundësinë eqasjessëpersonaveme aftësi të kufizuarapodizajniminipërtë gjithë shfrytëzuesit.
2. Autoritetikontraktuesdot'i përpilojësifikimetetknikenëatë mënyrëqëatotë jenë në përputhjemeqëllimineprokurimitdhe tëdrejtuaara drejtsigurimittëqasjessa mëtëmirëpërtë gjithëoperatorëte interesuarekonomikdhetenderuesit. Autoriteti kontraktuesështëveçanërishti ndaluarqëtetëhartojësifikimeteknikeqë

favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Bazuar në përshkrimin e mësipërm kërkojmë nga Autoriteti kontraktues respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit që të nxjerr këtë:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar Kërkesa “**KAG – Asphalt Company**” SH.P.K për Rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugës Kultur , Pasha dhe Demirci në Mamushë**, të plotësoni dhe rregulloni dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë me vërejtjet tona si në Kërkesë për Rishqyrtim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

1. Do të kerkohen në fazë tjetër.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*